



e Rahovecit

U vu gurthemeli i Qendrës Rinore dhe Kulturore në Rahovec

Objekti ka një sipërfaqe totale prej 6,203.24 m².
Përmban salla universale/auditorium, shkollë të muzikës, qendër për inovacion dhe teknologji, bibliotekë, galeri të arteve, kafetari me kuzhinë, administrata e objektit, parking nëntokësor dhe të jashtëm.
Vlera e kontratës është:
2,982,584.55 €.




Vihet gurthemeli i muzeut “Bajram Curri” në Krushë të Madhe



Ky objekt muzeor me arkitekturë të veçantë, ka: dy kate me 200 m², hapësirë për artefakte dhe hapësira të tjera për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme.
Objekti do të kushtojë:
119,754.75 euro.

Në kuadër të platformës elektronike "Rahoveci digjital", lansohet projekti "Harta e lirisë"



Në "Hartën e lirisë" janë paraqitur lapidarët e dëshmorëve, varrezat e dëshmorëve, varrezat e martirëve, pikat e zjarrit të UÇK-së, barrikadat, ambulancat, muzetë, shtëpitë që kanë shërbyer si shtabe të UÇK-së, shtëpitë që kanë shërbyer si baza të organizimit, strehë dhe logjistikë të UÇK-së.

Me anë të kësaj harte, synohet të ruhen dhe të promovohen vlerat e luftës së Ushtrisë Çlirimtare dhe të popullit shqiptar në tërë territorin e komunës së Rahovecit.

Në bronz ndriçon Piktori

Në Rahovec, u zbulua busti i dëshmorit të kombit, Gëzim Hamza-Piktori, në oborrin e shkollës që me krenari mban emrin e tij.



Në kuadër të rregullimeve infrastrukturore të shërbimeve publike, në qendër të Krushës së Madhe është bërë përrurimi i parkut.

Në qytetin e Rahovecit është bërë rregullimi me kubëza i 21 segmenteve rrugore.

Kanë mbaruar punimet e eficiencës në shkollën "Rilindja" në Çifllak dhe në shkollën "Faik Koncia" në Celinë.

